



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

06/2020

DREJTËSIA ADMINISTRATIVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2019



PRISHTINË, MAJ 2020

Autoret: Gzime Hashani dhe Tringa Ramadani

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Maj 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Metodologjia	6
3.	Korniza Ligjore	7
3.1.	Procedura gjyqësore administrative	8
4.	Standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira në fushën e drejtësisë administrative.....	10
5.	Ngarkesa e Departamentit për Çështje Administrative në GjTh në Prishtinë.....	13
5.1.	Ngarkesa ndër vite e Departamentit për Çështje Administrative të GjTh në Prishtinë.....	13
5.2.	Ngarkesa më lëndë e Departamentit për Çështje Administrative në GjTh në Prishtinë-viti 2019	15
6.	Ngarkesa e departamentit për çështje administrative në Gjykatën e Apelit -viti 2019	18
7.	Ngarkesa më lëndë e Administrative në Gjykatën Supreme gjatë vitit 2019.....	19
8.	Ngarkesa dhe performanca individuale e gjykatësve në DÇA të GjTh në Prishtinë dhe GjA-viti 2019	20
9.	Gjetjet e IKD-së mbi Departamentin për Çështje Administrative	23
9.1.	Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve në Departamentin për Çështje Administrative	27
9.2.	“Ping Pongu” me rastet në Drejtësinë Administrative	27
9.3.	Publikimi i aktgjykimeve të rasteve administrative	29
9.4.	Cilësia e aktgjykimeve të GjTh dhe GjA në rastet administrative	30
9.5.	Zvarritja e procedurës dhe ngarkesa e gjykatës me rastet e pensioneve	32
10.	ANNEX 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike të DÇA-ve	34
11.	Rekomandime	48

Lista e shkurtesave

DÇA	Departamenti për Çështje Administrative
GjA	Gjykata e Apelit
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
GjThP	Gjykata Themelore Prishtinë
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPMSHCK	Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës
LKA	Ligji për Konfliktet Administrative
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative

1. Përmbledhje ekzekutive

Rendi kushtetues dhe juridik kosovar ndërtohet mbi parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për të cilin parim janë përcaktuar një mori normash kushtetuese dhe ligjore, si dhe janë inkorporuar edhe instrumente ndërkombëtare, që në letër thuhet se zbatohen drejt për së drejti në rendin juridik kosovar.

Sa i përket padive të qytetarëve ndaj shtetit, përkatësisht ndaj institucioneve publike, kjo fushë rregullohet në parime nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës derisa sanksionimi specifik bëhet me anë të ligjeve, që duhet të jenë në përputhje me këto parime kushtetuese.

Me qëllim të garantimit të gjyqësisë administrative, Ligji për Gjykatat i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, ka themeluar edhe Departamentin për Çështje Administrative (DÇA), i cili departament funksion në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë si shkallë e parë për këto raste, me kompetencë për tërë territorin e Kosovës, por edhe në Gjykatën e Apelit si shkallë e dytë, e cila shqyrton ankesat në këto raste.

Nga analiza e IKD-së del se trajtimi i padive ndaj shtetit nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës po merr tatëpjetën vazhdimisht. Kjo tatëpjetë argumentohet me anë të dy faktorëve: fillimisht, ngarkesa aktuale e këtij departamenti nuk garanton trajtim efikas të lëndëve, siç do të shihet më poshtë. Trajtimi i lëndëve jo brenda një afati të arsyeshëm, më së paku paraqet shkelje të kushtetutës. Andaj, gjendja aktuale nuk është një gjendje solide. Ndërsa, pikërisht kjo gjendje po vazhdon ende përkeqësimin, duke mos dhënë sinjale pozitive për progres.

Përderisa si qëllim kryesor i sistemit gjyqësor proklamohet të jetë ulja e numrit të lëndëve, fundi i vitin 2019 i ka gjetur DÇA-të me numër më të madh të lëndëve se sa në fillim të këtij viti. Përderisa gjyqtarët e DÇA të GjA mesatarisht e kanë tejkaluar normën vjetore të kryerjes së lëndëve, këtë normë sipas mesatares nuk e kanë arritur gjyqtarët e DÇA të GjTh në Prishtinë.

E drejta kushtetuese e qytetarëve për mjet efektiv ligjor vazhdon të mbetet një normë kushtetuese e shkelur në vazhdimësi, derisa mënyra e veprimit të DÇA-ve duke kthyer lëndët përsëri në organet administrative është bërë burim i zvarritjes së qytetarëve për realizimin e të drejtave të tyre. Për më tepër, IKD në këtë raport gjenë se kjo mënyrë e veprimit tregon mos arritje të qëllimit bazë të drejtësisë administrative, e që është futja e të gjitha institucioneve nën parimin e legalitetit sipas hierarkisë ligjore.

Në anën tjetër, përderisa standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira theksojnë rëndësinë e aktgjykimit të arsyetuar, IKD në këtë raport gjenë aplikim të metodës “copy-paste” në hartimin e aktgjykimeve në rastet administrative.

Po ashtu, IKD në këtë raport gjenë se përballë obligimit të gjykatave që të publikojnë të gjitha aktgjykimet, GjTh në Prishtinë nuk ka publikuar gjithsej 2,672 aktgjykime administrative, derisa GjA nuk ka publikuar gjithsej 696 aktgjykime.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve në Departamentin për Çështje Administrative, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare përfshi legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të KGJK-së, si dhe të dhëna të tjera të siguruara nga institucionet gjyqësore përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përpos këtyre dokumenteve, përpilimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së gjyqtarëve në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në DÇA në GjTh-në Prishtinë. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD-ja tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e rasteve të DÇA-së të GjTh në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, për periudhën kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë disa prej rasteve më karakteristike të DÇA-së .

Sa i përket DÇA-së së GjTh në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, IKD në këtë raport ka analizuar ngarkesën me lëndë të këtij departamenti, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancën individuale të gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport ka dhënë vlerësimet dhe rekomandimet konkrete se si duhet të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti në trajtimin e këtyre rasteve.

Në këtë raport, IKD ka analizuar gjetjet kryesore nga monitorimi sistematik i drejtësisë administrative, derisa në annexin 1 të këtij raporti do të trajtohen edhe raste të përzgjedhura të proceseve gjyqësore administrative.

3. Korniza Ligjore

Drejtësia administrative në Kosovë rregullohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta, ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse në këtë fushë, të cilat duhet të jenë në harmoni mes vete, duke respektuar parimin e hierarkisë juridike në rendin kushtetues kosovar.

Fillimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e mjeteve juridike, e cila në nenin 32 nënvizon se: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*.

Krahas kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, ku në nenin 54 përcakton se *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*.

Në këtë mënyrë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës u ka dhënë mundësi gjithë qytetarëve që të sfidojnë vendimet e institucioneve publike përmes procedurave gjyqësore.

Në anën tjetër, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka inkorporuar tetë instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat zbatohet drejt për së drejti në rendi juridik kosovar, dhe të cilat kanë epërsi ndaj ligjeve të tjera¹.

Në kuadër të këtyre instrumenteve ndërkombëtare, ndër më kryesoret është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Neni 13 i kësaj konvente garanton të drejtën për zgjidhje efektive, në të cilin nen thuhet se: *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*.

Në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky nen ashtu si edhe të gjitha nenet e tjera që kanë për objekt të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të interpretohen në harmoni me vendimet e GjEDNj-së².

Tutje, Mjeti juridik efektiv garantohen edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, ku neni 8 i kësaj konvente përcakton se: *“Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet”*.

Për më tepër, kjo çështje rregullohet edhe me nenin 2.3.1 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ku nënvizohet se: *“Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të siguroj që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti*

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

² Po aty. Neni 53 *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

juridik efektiv, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”.

Në anën tjetër, me qëllim të sendërtimit praktik të këtyre dispozitave kushtetuese, Republika e Kosovës ka miratuar një mori ligjesh, me qëllim të konsolidimit të procedurës gjyqësore administrative, apo konfliktit administrativ.

Lidhur me kompetencën e institucioneve gjyqësore për trajtimin e padive ndaj akteve administrative të institucioneve publike, Ligji për Gjykatat ka përcaktuar themelimin e një departamenti të veçantë për trajtimin e këtyre rasteve.

Neni 13.4 i Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat përcakton decidivisht se “Çështjet administrative janë kompetencë ekskluzive e Gjykatës Themelore të Prishtinës”. Ndërsa, sa i përket organizimit të brendshëm të Gjykatave, ky ligj përcakton se “Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës”³.

Po ashtu, ligji në fjalë përcakton edhe themelimin e këtij departamenti për kuadër të Gjykatës së Apelit⁴, derisa për mjetet e jashtëzakonshme juridike, kompetencë për vendosje ka Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës⁵.

3.1. Procedura gjyqësore administrative

Ligji i cili rregullon procedurën gjyqësore administrative është Ligji Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), i hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2010, e që ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike⁶.

Inicimi i procedurës pranë organit administrativ bëhet përmes kërkesës së parashtruar nga pala apo qytetari, me anë të së cilës kërkohet kryerja e ndonjë shërbimi, procedurë kjo e cila rregullohet me Ligjin nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA).

Sipas LPPA-së, kjo kërkesë duhet të shqyrtohet brenda një afati të arsyeshëm kohor, e paraparë kjo edhe në nenin 10.2 të këtij ligji, ku thuhet: *“Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative”.*

³ Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 13.1.3.

⁴ Po aty, neni 24.1.5.

⁵ Po aty, neni 26.

⁶ Ligji për Konfliktet Administrative, neni 2.

Ndaj çdo vendimi që merret në procedurë administrative, ligji parasheh të drejtën për ankesë si mjet i rregullt juridik. Sipas LKA-së, e gjithë kjo procedurë duhet t'i paraprijë konfliktit administrativ.

Çdo qytetarë i pa kënaqur me një vendim administrativ, përmes ankesës mund të kërkoj rishikimin e atij vendimi nga një instancë më e lartë, apo përmes padisë në gjykatë, nëse ndaj vendimit të shkallës së parë nuk lejohet ankesa.

Shkalla e dytë brenda këtij organi administrativ shqyrton ankesat, të cilat mund t'i refuzoj si të pabazuara, duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, apo edhe mund të anuloj vendimin e shkallës së parë, dhe të vendosë se pala ka të drejtë në kërkesën e bërë.

Kur edhe shkalla e dytë vendos në disfavor të palës, LKA i garanton të drejtën për inicim të konfliktit administrativ që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, konkretisht në Departamentin për Çështje Administrative, e cila ka kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Pas pranimit të lëndës përmes konfliktit administrativ, DÇA mund ta aprovoj, refuzoj, apo të kthej rastin në rivendosje tek organi administrativ.

Ndërsa, ndaj vendimit të Gjykatës Themelore, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe ankesë kushtetuese në Gjykatës Kushtetuese, sipas neni 113.7 të Kushtetutës.

Deri tek një vendim përfundimtar, pa të drejtë ankese në instanca tjetër administrative apo gjyqësore, numri i vendimeve mund të shkoj deri në gjashtë, dy vendime administrative dhe tri vendime gjyqësore dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese. I gjithë ky numër i vendimeve mund të shfaqet nëse secili institucion vendos në mënyrë meritore, pasi kthimi i rastit në rivendosje rrit numrin e vendimeve në një rast të vetëm.

4. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira në fushën e drejtësisë administrative

Shqyrtimi gjyqësor efektiv i akteve administrative në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të palëve është një element esencial i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut⁷.

Forcimi i shtetit të së drejtës fillon me garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, kështu që përmes një shqyrtimi gjyqësor të akteve administrative, eliminohet mundësia e shkeljes së të drejtave të njeriut me këto akte. Në këtë mënyrë garantohet edhe funksionimi në praktikë i shtetit ligjor.

Standardi fundamental i mbrojtës së të drejtave dhe lirive të njeriut është garantimi i një procesi të drejtë gjyqësor dhe të paanshëm, përmes rishikimit gjyqësor të akteve administrative, kontroll ky i cili shmang ushtrimin e paligjshëm të autoritetit nga pushteti ekzekutiv.

Kontrolli gjyqësor i akteve administrative konform standardeve ndërkombëtare ushtrohet me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në frymën e KEDNj dhe akteve të tjera ndërkombëtare.

Këto standarde konsistojnë në sigurimin e një gjykimi të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, të drejtën e palëve që çështja e tyre të dëgjohet në gjykatë, të drejtën për një vendim të bazuar në prova dhe fakte, të qartë e të arsyetuar mirë.

Në këtë drejtim, Këshilli i Evropës ka nxjerr një sërë rezolutash e rekomandimesh, me të cilat kanë për synim sigurimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, përmes kontrollit të ligjshmërisë së akteve administrative.

Sipas rekomandimit Rec(2004)20 të Këshillit të Evropës, palëve duhet t'iu ipet mundësia që të atakojnë aktet administrative, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në të drejtat dhe interesat e tyre. Ndër të tjera, rekomandohen shtetet anëtare që zgjidhja e rasteve më kërkesën për rishikimin e akteve administrative të bëhet brenda afatit të arsyeshëm kohorë. Po ashtu, rekomandohet që në rast se gjykata konstaton se një akt administrativ është i kundërligjshëm, duhet të ketë kompetenca që të korrigjoj aktin administrativ, në mënyrë që të jetë në përputhje me ligjin. Në mënyrë specifike thekson kompetencën që të prish aktin administrativ dhe nëse është e nevojshme çështjen t'ua kthej autoriteteve administrative për të marrë një vendim të ri që përputhet me aktgjykimin.

Në këtë drejtim, mbi parimin e një gjykimi të drejtë bazohet edhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e cila në nenin 14 të saj, ka siguruar se secili person ka të drejtën që çështja e tij të dëgjohet në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme.

⁷ Rekomandimi Rec.(2004)20 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës për rishikimin gjyqësor të akteve administrative. 15 dhjetor 2004. Shih [linkun \(https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805db3f4\)](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805db3f4)

Mbi këto parime bazohet edhe Konventa Evropiane për të drejta Civile dhe Politike, e cila në nenin 14 të saj siguron gjykim të drejtë e në kohë të arsyeshme⁸.

Standarde të larta në sigurimin e një gjykimi të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme ka vendosur edhe Konventa Amerikane për të Drejta të Njeriut, si dhe Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit.⁹

“Çdo individ do të ketë të drejtë ta dëgjojë çështjen e tij. Kjo përfshin: E drejta për t'u bërë thirrje organeve kompetente kombëtare kundër akteve të shkeljes së të drejtave të tij themelore, të njohura dhe të garantuara nga konventat, ligjet, rregulloret dhe zakonet në fuqi. E drejta për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë ose gjykatë e paanshme”¹⁰

Gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme, është njëri ndër parimet fundamentale të akteve ndërkombëtare.

Lidhur me afatin e arsyeshëm, praktika gjyqësore e GjEDNj-së, afatin "e arsyeshëm" nuk e konsideron vetëm kohën kur paraqitet konflikti administrativ në gjykatë, por prej momentit kur pala kërkon një mjet të brendshëm brenda administratës¹¹.

Për zhvillimin e një procedure të rregullt të konfliktit administrativ, konsiderohet me rëndësi respektimi i parimit të publicitetit dhe publikimit të vendimit gjyqësor lidhur me aktin administrativ të atakuar.

Kjo për faktin se të gjithë personave të interesuar do t'u mundësohej qasja në një gjykim në të cilin ata kanë një interes të ligjshëm, madje parashihet edhe fakti që duhet të pasur në konsideratë gjuhën e cila duhet të jetë e kuptueshme për palët dhe qasja sa më e lehtë në këto vendime.¹²

Një rëndësi e veçantë i ipet arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së arsyetimi i aktgjykimit duhet të jetë i qartë, arsyet e dhëna duhet të jenë specifike dhe të përshtatshme për faktet e çështjes, pasi që mungesa ose pamjaftueshmëria e arsyeve të dhëna mund të dëmtojë gjykimin.¹³

⁸ Konventa Evropiane për të drejta Civile dhe Politike. Neni 14. 16 dhjetor 1966. (Shih [Linkun https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx](https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

⁹ Konventa Amerikane për të Drejta të Njeriut. Neni 8. 22 nëntor 1969. (Shih [linkun https://www.cidh.oas.org/basicos/english/basic3.american%20convention.htm](https://www.cidh.oas.org/basicos/english/basic3.american%20convention.htm)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

¹⁰ Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit. Neni 7. 27 qershor 1981. (Shih [linkun https://www.achpr.org/legalinstruments/detail?id=49](https://www.achpr.org/legalinstruments/detail?id=49)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

¹¹ Draft Memorandumi i rekomandimeve nga Këshilli i Ministrave të Këshillit Evropian. 16 janar 2004. Strasburg (Shih [linkun https://rm.coe.int/0900001680928e63](https://rm.coe.int/0900001680928e63)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

¹² Draft Memorandumi i rekomandimeve nga Këshilli i Ministrave të Këshillit Evropian. Parimi 4.g. 16 janar 2004. Strasburg. (Shih [linkun https://rm.coe.int/0900001680928e63](https://rm.coe.int/0900001680928e63)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

¹³ Draft Memorandumi i rekomandimeve nga Këshilli i Ministrave të Këshillit Evropian. Parimi 4.h. 16 janar 2004. Strasburg. (Shih [linkun https://rm.coe.int/0900001680928e63](https://rm.coe.int/0900001680928e63)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

*“Arsyet duhet të jepen në aktgjykim. Gjykatat duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ato mbështesin vendimet e tyre”.*¹⁴

Po ashtu, kërkohet nga gjykata që të ketë kujdes në përdorimin e terminologjisë gjatë hartimit të aktgjykimit, pasi që kërkohet nga gjykata që të përdorë terminologji të qartë dhe të kuptueshme për palën e cila paraqet padi.¹⁵

GjEDNj në rastin “Z dhe të tjerët”, ka paraparë që gjykata ka juridiksion jo vetëm që të merret me ligjshmërinë e aktit administrativ, por edhe kur padia e paditësit aprovohet, kur është e përshtatshme t’i mundësohet dëmshpërblimi, si për dëmin material ashtu edhe për dëmin jo material¹⁶.

¹⁴ Rekomandimi Rec.(2004)20 i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës për rishikimin gjyqësor të akteve administrative. Pika B. Parimet: h. 15 dhjetor 2004. Shih linkun (https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805db3f4). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020)/

¹⁵ Po aty.

¹⁶ GjEDNj. Aktgjykim “Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar”. 10 maj 2001. Paragrafi.107. Shih linkun ([https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22001-59455%22%7D%7D](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-59455%22%7D%7D)). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

5. Ngarkesa e Departamentit për Çështje Administrative në GjTh në Prishtinë

Më qëllim të krijimit të një pasqyre sa më reale, IKD ka analizuar numrin e lëndëve që trashëgohen vit pas viti, numrin e lëndëve të pranuar, numrin e lëndëve në punë, numrin e lëndëve të zgjidhura si dhe atyre të pazgjidhura në këtë departament, gjatë vitit 2019.

Analizimi i këtyre statistikave nga IKD paraqet një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së DÇA-ve, me anë të së cilës pasqyrë, tregohet trendi, performanca por edhe matet progresi dhe regresi i sistemit të drejtësisë në trajtimin e padive ndaj shtetit.

5.1. Ngarkesa ndër vite e Departamentit për Çështje Administrative të GjTh në Prishtinë

Me qëllim të pasqyrimit sa më të saktë të punës ndër vite të DÇA-së të GjTh në Prishtinë, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që ky departament ka pasur nga viti 2016 deri më 31 dhjetor 2019¹⁷.

Bazuar në raportet statistikore të gjykatave që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) publikon çdo vit kalendarik, DÇA i GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2016 ka pasur në punë gjithsej 7,596 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2,404 apo rreth 32% të lëndëve, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur 5,192 lëndë apo rreth 68% e tyre.

Gjatë vitit 2017, ky departament ka pasur në punë gjithsej 7,572 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur 2,268 apo 30% të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 5,304 apo 70% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, DÇA i GjTh në Prishtinë ka pasur në punë 8,312 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur 2,219 ose rreth 27% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 6,093 ose rreth 73% e tyre.

Ndërsa, gjatë vitit 2019, departamenti në fjalë ka pasur në punë 9,244 lëndë, prej të cilave, 2,929 apo rreth 32% janë lëndë të zgjidhura, kurse 6,315 apo rreth 68% është numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura.

Sipas këtyre gjetjeve, numri i lëndëve të zgjidhura ka pësuar rënie gjatë viteve 2016-2018, ndërkaq në vitin 2019, kur edhe numri i lëndëve të pranuar ka shënuar rritje, lëndët e pazgjidhura mbesin ende në numër të madh, dhe të njëjtat barten vit pas viti.

Në fund të vitit 2017, numri i lëndëve të pazgjidhura të cilat barten në vitin pasues ishte ngritur për gjithsej 112 lëndë. Në vitin 2018, ky numër ishte ngritur për gjithsej 789 lëndë, derisa në vitin 2019, ky numër ishte ngritur për gjithsej 222 lëndë.

¹⁷ Kjo analizë është po ashtu pjesë e raportit paraprak të IKD-së mbi drejtësinë administrative, por se është për periudhën kohore të cilës i referohet raporti në fjalë. Shih për më tepër: “*Drejtësia Administrative në Kosovë, Ligji VS Praktika*”. IKD. Shtator 2019. f.11-12 (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Drejt%C3%ABsia-Administrative_Final-19.09.2019-BM.pdf). (Qasur për herë të fundit më 4 maj 2020).

Në anën tjetër, në DÇA në GjTh të Prishtinës nga viti 2016 vazhdimisht është ngritur numri i lëndëve të pranuar. Në vitin 2016, ky departament kishte pranuar gjithsej 2,216 lëndë, derisa në vitin 2017 kishte pranuar 2,380 lëndë, apo 164 lëndë më shumë se sa në vitin paraprak. Në vitin 2018, ky departament kishte pranuar gjithsej 3,008 lëndë, përkatësisht 628 lëndë më shumë se sa në vitin paraprak, derisa në vitin 2019, ky departament ka pranuar në punë gjithsej 3,151 lëndë, apo 143 më shumë se sa në vitin 2018.

Në këtë mënyrë, shihet se rritja e numrit të lëndëve të pranuar si faktor i vetëm për ngritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit ka ndikuar vetëm në vitin 2017, derisa këto lëndë nuk kanë qenë arsye të vetme në vitin 2018 dhe 2019, pasi gjatë këtyre dy viteve, numri i lëndëve të pazgjidhura është ngritur më shumë se sa ngritja e numrit të lëndëve të pranuar.

Në këtë drejtim, nga analiza e IKD-së del se trajtimi i padive ndaj shtetit nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës po merr tatëpjetën vazhdimisht. Kjo tatëpjetë argumentohet me anë të dy faktorëve: fillimisht, ngarkesa aktuale e këtij departamenti nuk garanton trajtim efikas të lëndëve, siç do të shihet më poshtë. Trajtimi i lëndëve jo brenda një afati të arsyeshëm, më së paku paraqet shkelje të kushtetutës. Andaj, gjendja aktuale nuk është një gjendje solide. Ndërsa, pikërisht kjo gjendje po vazhdon ende përkeqësimin, duke mos dhënë sinjale pozitive për progres.

IKD i rikujton fillimisht KGJK-së mbi rëndësinë e trajtimit efikas të lëndëve administrative, ku KGJK duhet ta ketë parasysh se nisur nga fakti se kemi të bëjmë me padi ndaj institucioneve shtetërore, për rastet ku qytetarët konsiderojnë shkelje të të drejtave të tyre, trajtimi efikas dhe efektiv i këtyre rasteve mbronë tërë rendin kushtetues dhe juridik në Republikën e Kosovës.

Në anën tjetër, krahas të gjitha lëndëve të tjera, lëndët administrative dhe ekonomike janë të centralizuara në një departament të vetëm, në vetëm një GjTh. Ky centralizimin i kompetencës, domosdoshmërisht i jep mundësi më të madhe KGJK-së që ta skanoj situatën, dhe të ndërhyjë me kohë. Ndërhyrja e KGJK-së në këtë rast konsiston në disiplinimin e gjyqtarëve të cilët nuk e arrijnë normën, si dhe në ndërmarrjen e masave objektive për të sanuar këtë gjendje të këtij departamenti, e cila po vazhdon regresin.

Për më tepër, në kuptim të normës, IKD vlerëson se rregullorja aktuale e KGJK-së e cila përcakton normat e gjyqtarëve në të gjitha fushat është një rregullore e cila nuk adreson drejt përgjegjësinë e secilit gjyqtar në kuptim të arritjes së objektivave të caktuar, shtuar këtu faktin se e njëjta rregullore zbatohet përshtatshmërisht, pasi e njëjta është miratuar në sistemin e kaluar gjyqësor, para reformimit të të njëjtit. Përpos çështjeve administrative, kjo rregullore mbi normat po vazhdon të shfaqet si pengesë në progresin e sistemit gjyqësor edhe në fusha të tjera gjyqësore.

Andaj, për këto arsye, IKD i rekomandon KGJK-së që sa më shpejt të formojë një grup punues të përbërë nga përfaqësues të KGJK-së, gjyqtarë, ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, dhe të analizojë situatën në teren, dhe të draftojë e miratojë një rregullore e cila përcakton objektiva të qarta për secilin gjyqtar, ku objektiv përfundimtar i kësaj rregullore do të jetë stabiliteti me lëndë në sistemin gjyqësor.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë se ngritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura ka ardhur si rezultat i pranimit të numrit të madh të lëndëve si dhe mungesës së numrit të gjyqtarëve.


“Departamenti për Çështje Administrative (DÇA), që nga viti 2013 ka trashëguar dhe ka pranuar në vazhdimësi një numër të madh të lëndëve nga Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Apelit dhe gjykatat e tjera regjionale, në bazë të kompetencave të reja Ligji 03/L-100 për Gjykata. Vetëm në vitin 2018, DÇA-Divizioni Fiskal, ka pranuar më shumë se 300 lëndë të reja brenda 3 muajve nga Gjykata e Apelit, për ti gjykuar në rivendosje. Gjatë kësaj periudhe kohore 2016-2019 DÇA përveç lëndëve të reja, ka pranuar vazhdimisht edhe lëndë nga gjykatat tjera për shkak të kompetencës lëndore respektivisht ndryshimeve të strukturës ligjore. Me ndryshimin e Ligjit për Kundërvajtje është rrit numri e lëndëve ne DÇA e të cilat me herët kanë qenë në kompetencë Divizionit për kundërvajtjeje. Vetëdijesimi i qytetarëve për ta atakuar vendimet administrative të lëshuar nga institucionet administrative, ka ndikuar në rritjen e lëndëve- e që kjo ndërlidhet me besimin e gjyqësorit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative. Gjithashtu, rritja e numrit të lëndëve në Departamenti për Çështje Administrative, është si pasoje e numrit të vogël të gjyqtareve të cilët janë të angazhuar në këtë departament, pranimi i numrit të madhe të lëndëve, ku brenda muajit një gjyqtar i pranohet përafërsisht 50 deri në 60 lëndë - pra më shumë lëndë pranohen në muaj se sa mund të punoj një gjyqtar brenda muajit - një gjyqtarë përafërsisht brenda një muaji i punon 25 deri në 30 lëndë. Për me tepër ende nuk kemi nga KGJK Rregullore që do të përcaktonte normën obliguese mujore për gjyqtar”¹⁸.

Lidhur me rregullohen mbi normat orientuese për gjyqtarë, IKD rithekson se rekomandimin se kjo rregullore duhet të ndryshohet konform kërkesave të arsyetuara në këtë raport, por se deri në ndryshimin e të njëjtën, rregullorja aktuale e KGJK-së, e miratuar më 14 shtator 2011, mbetet në fuqi.

5.2. Ngarkesa më lëndë e Departamentit për Çështje Administrative në GjTh në Prishtinë-viti 2019

Gjatë vitit 2019, DÇA i GjTh në Prishtinë ka pasur në punë 9,244 lëndë, prej të cilave, 2,929 apo 31.68% janë lëndë të zgjidhura, kurse 6,315 apo 68.31% është numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura.


¹⁸ Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Përgjigje elektronike për IKD. 07.05.2020.



Grafika 1: Përqindja e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2019 në DÇA të Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Nga totali i lëndëve që DÇA i GjTh në Prishtinë ka pasur në punë gjatë vitit 2019, 6,093 lëndë janë trashëguar nga viti 2018, derisa janë gjatë vitit 2019 janë pranuar edhe 3,151 lëndë të reja.

Nga të gjitha lëndët që ka pasur në punë, ky departament ka zgjidhur 2,929 lëndë, ndërsa në vitin 2020 ka bartur gjithsej 6,315 lëndë.



Grafika 2: Numri i lëndëve të trashëguara, pranuar, zgjidhura dhe pazgjidhura nga DÇA i GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2019.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2019, numri i lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti është ngritur edhe për 222 lëndë. Kjo për arsye se përballë numrit të lëndëve të pranuar gjatë vitit 2019, DÇA i GjTh në Prishtinë gjatë të njëjtit vit ka zgjidhur 222 lëndë më pak.

Thënë më ndryshe, intenca e sistemit gjyqësor për të ulur numrin e lëndëve të cilat barten nga viti në vit, gjatë vitit 2019 në DÇA të GjTh në Prishtinë ka shkuar në drejtim të kundërt, dhe

kjo nisur nga fakti se ky departament më pak ka pasur lëndë të pazgjidhura në fillim të vitit 2019 se sa në fund të të njëjtit vit.

6. Ngarkesa e departamentit për çështje administrative në Gjykatën e Apelit -viti 2019


Me qëllim të pasqyrimin të numrit të lëndëve ndër vite në DÇA të GjA, IKD ka analizuar statistikat zyrtare të KGJK-së për këtë departament sa i përket vitit 2016, 2017, 2018 dhe vitit 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, DÇA i Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2016 ka pasur në punë gjithsej 760 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 426 apo mbi 56% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 334 lëndë apo afër 44% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, ky departament gjithsej në punë ka pasur 890 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 472 apo mbi 53% të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 418 apo afër 47% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, DÇA i Gjykatës së Apelit ka pasur në punë 1,083 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 748 ose mbi 69% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 335 ose afër 31%.

Ndërsa, në vitin 2019, DÇA i kësaj gjykate ka pasur në punë 1,369 lëndë, 825 prej të cilave apo afër mbi 60% janë zgjidhur, kurse numri i lëndëve të pazgjidhura është 544 apo afër 40%.



Grafika 3: Përqindja e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2019 në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatën e Apelit.

Nga statistikat e mësipërme shihet se DÇA i Gjykatës së Apelit ndër vite ka ngritur numrin e lëndëve të zgjidhura, derisa kemi një ngritje të lehtë në numrin e lëndëve të pazgjidhura në vitin 2019.


Por, IKD gjenë se numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitin 2019 nuk vie si rezultat i uljes së efikasitetit të gjyqtarëve të DÇA-së në GjA, por se kemi të bëjmë me ngritje të numrit të lëndëve të pranuar, ku për dallim nga viti 2018, gjatë vitit 2019 në këtë departament janë pranuar 369 lëndë më shumë.

7. Ngarkesa më lëndë e Administrative në Gjykatën Supreme gjatë vitit 2019

IKD në raportin e kaluar mbi drejtësinë administrative kishte gjetur se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka arritur një stabilitet me lëndë, i cili stabilitet i mundëson kësaj gjykate që të sigurojë trajtimin e rasteve administrative brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata Supreme gjatë vitit 2019 ka pasur në punë vetëm 3 lëndë administrative, të pranuar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ku po gjatë vitit 2019, i ka zgjidhur këto tri lëndë.

Ndërsa, lëndë administrative të pranuar sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme gjatë vitit 2019 ka trashëguar nga viti 2018 vetëm katër (4) lëndë, derisa ka pranuar edhe 153 lëndë të tjera, që i bie se në total, gjatë vitit 2019 ka pasur në punë gjithsej 157 lëndë të kësaj natyre. Prej tyre, Gjykata Supreme ka zgjidhur 156 lëndë, duke e përfunduar vitin me vetëm një lëndë të bartur për vitin pasues.



Grafika 4: Lëndët e zgjidhura gjatë vitit 2019 në Gjykatën Supreme.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se deri më tani, vetëm Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka arritur të ketë një gjendje stabile të ngarkesës me lëndë, e cila gjendje i mundëson kësaj gjykate që të garantojë mjetin efektiv juridik.

8. Ngarkesa dhe performanca individuale e gjykatësve në DÇA të GjTh në Prishtinë dhe GjA-viti 2019

Gjatë vitit 2019, DÇA i GjTh në Prishtinë, ka qenë i ngarkuar me gjithsej 9,244 lëndë, derisa në këtë departament janë zgjidhur 2,929 lëndë.

Në këtë departament kanë qenë të angazhuar gjithsej 9 gjyqtarë, 3 prej të cilëve të angazhuar në divizionin fiskal të këtij departamenti, derisa 6 të tjerë janë të angazhuar në divizionin administrativ.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2019, secili gjyqtarë mesatarisht ka qenë i ngarkuar me nga 1,027 lëndë, mesatare kjo e përllogaritur për të dyja divizionet si total.

Ndërkaq, sa i përket lëndëve të zgjidhura, në DÇA të GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2019 secili gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht nga 325.4 lëndë.

Sipas Rregullores për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve, gjyqtarët e DÇA të GjTh në Prishtinë janë të obliguar që gjatë një viti të zgjedhin 329 lëndë, që i bie se në mesatare, gjyqtarët e këtij departamenti nuk e kanë arritur normën e përcaktuar nga KGJK, duke zgjidhur mesatarisht nga 3.6 lëndë më pak.

Lidhur me këtë gjetje të IKD-së, IKD ka dërguar kërkesë për informata tek Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Për këtë pjesë, pyetja e IKD-së ka qenë si në vijim: Gjatë vitit 2019, DÇA i GjTh në Prishtinë, ka qenë i ngarkuar me gjithsej 9,244 lëndë, derisa në këtë departament janë zgjidhur 2,929 lëndë. Në këtë departament kanë qenë të angazhuar gjithsej 9 gjyqtarë, 3 prej të cilëve të angazhuar në divizionin fiskal të këtij departamenti, derisa 6 të tjerë janë të angazhuar në divizionin administrativ. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2019, secili gjyqtarë mesatarisht ka qenë i ngarkuar me nga 1,027 lëndë, mesatare kjo e përllogaritur për të dyja divizionet si total. Ndërkaq, sa i përket lëndëve të zgjidhura, në DÇA të GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2019 secili gjyqtar ka zgjidhur mesatarisht nga 325.4 lëndë. Sipas Rregullores për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve, gjyqtarët e DÇA të GjTh në Prishtinë janë të obliguar që gjatë një viti të zgjedhin 329 lëndë, që i bie se në mesatare, gjyqtarët e këtij departamenti nuk e kanë arritur normën e përcaktuar nga KGJK, duke zgjidhur mesatarisht nga 3.6 lëndë më pak. Si e vlerësoni këtë?”.

Kjo gjetje e IKD-së është kontestuar nga Kryetarja Bytyçi, e cila në përgjigjen e saj, është kufizuar tek divizioni fiskal, dhe jo tek DÇA si tërësi, përkundër faktit se pyetja e IKD-së nënvizonte faktin e përllogaritjes së mesatares për DÇA-në në tërësi:

“Sa i përket Divizionit Fiskal, nuk qëndrojnë të gjeturat e KDI lidhur me ngarkimin e lëndëve me mesatare 1,027 lëndë, sepse 3 gjyqtarët e këtij Divizioni i kanë aktualisht rreth 400 lëndë secili apo në total rreth 1250 lëndë. Ndërsa lëndë të kryera për vitin 2019 janë më shumë se sa lëndët e pranuar për këtë periudhë, dhe në këtë mënyrë edhe është zvogëluar numri i lëndëve të vjetra të cilat kanë pritur për tu zgjidhur në gjykatë”.

IKD i rikujton Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, se të gjitha të dhënat statistikore janë marrë nga raportet zyrtare të publikuara nga KGJK. Në këtë drejtim,

analiza dhe përlogaritja është bërë për departamentin si tërësi, dhe jo të ndarë në divizione. Arsye për këtë është se vetë raportet e KGJK-së nuk japin të dhëna të ndara për dy divizionet e DÇA-së, por i pasqyrojnë si tërësi të dhënat statistikore për këtë departament¹⁹.

Në anën tjetër, gjatë këtij viti 2019, DÇA në Gjykatën e Apelit ka pasur në punë gjithsej 1,369 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 825 lëndë.

Në DÇA të GjA, kanë qenë të angazhuar 3 gjyqtarë, që i bie se mesatarisht secili gjyqtar ka pasur në punë nga 456 lëndë. Ndërsa, sa i përket lëndëve të zgjidhura, gjatë vitit 2019, secili gjyqtar i DÇA të GjA ka zgjidhur mesatarisht nga 275 lëndë.

Sipas Rregullores për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve, gjyqtarët e DÇA të GjTh në GjA janë të obliguar që gjatë një viti të zgjidhin 263 lëndë, që i bie se në mesatare, gjyqtarët e DÇA të GjA gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur nga 12 lëndë më shumë se sa norma e përcaktuar nga KGJK.

Në anën tjetër, në fund të vitit 2018 KGJK kishte bërë një hap progresiv në fushën e transparencës, ku kishte publikuar Raportin Vjetor të Punës së Gjyqtarëve për vitin 2018, në të cilin raport pasqyrohej puna e secilit gjyqtar, në kuptim të numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë vitin 2018.

Për publikimin e këtij raporti, IKD në gjitha raportet nga seria “ligji VS praktika” kishte njohur dhe vlerësuar këtë progres, të cilin veprim pozitiv të KGJK-së kishte kërkuar ta marrë shembull edhe KPK, duke publikuar raportin vjetor të punës së prokurorëve.

Por, progresin e shënuar në fund të vitit 2018, KGJK e ka kthyer përsëri në regres, pasi raporti vjetor mbi punën e gjyqtarëve për vitin 2019 nuk është publikuar nga KGJK. Përkundër kërkesave të vazhdueshme të IKD-së në institucionet gjyqësore, ky raport nuk është siguruar asnjëherë.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se KGJK dhe të gjitha institucionet e tjera gjyqësore duhet ta shtojnë tempon dhe nivelin e progresit, por se regresi nuk duhet të shfaqen në asnjë rast. Andaj, tërheqja prapa e KGJK-së nga një veprim shumë pozitiv në kuptim të transparencës, paraqet një shembull me negativitet të theksuar.

Duke u bazuar po në këtë raport, IKD kishte gjetur se në mes të gjyqtarëve të një departamenti të caktuar, ka disbalanc të madh sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura, ku IKD në këto raport kishte pasqyruar edhe tre (3) gjyqtarët me numrin më të madh të lëndëve të zgjidhura dhe tre (3) gjyqtarët me numrin më të vogël të lëndëve të zgjidhura.


Përsëritjen apo mos përsëritjen e kësaj dukurie gjatë vitit 2019 KGJK e ka mbajtur të fshehur, duke mos publikuar raportin vjetor mbi punën e gjykatësve për vitin 2019, të cilin raport e kishte publikuar për vitin 2018.

¹⁹ Po aty.

Andaj, për këtë arsye, IKD i rekomandon KGJK-së që të publikojë raportin vjetor të punës së gjyqtarëve për vitin 2019, dhe të njëjtin raport ta publikojë vazhdimisht për secilin vit, duke vazhduar shembullin e mirë të treguar në fund të vitit 2018.

9. Gjetjet e IKD-së mbi Departamentin për Çështje Administrative

IKD gjatë periudhës 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, ka monitoruar gjithsej 185 seanca në DÇA të GjTh në Prishtinë.



Grafika 5 – Seancat e monitoruara nga IKD.

Nga 185 seanca të monitoruara, 149 janë monitoruar në divizionin administrativ ndërsa 36 në divizionin fiskal.

Sipas statistikave të siguruara nga monitorimit i IKD-së, paditë më të shpeshta në gjykatë gjatë vitit 2019 kanë qenë ndaj MPMS-së lidhur me kërkesat për pensione dhe më të rralla ato me të cilat kontestohen vendimet e Inspektoratit të Punës.

Ndërsa nuk mungojnë rastet edhe ndaj KPMSHCK, ku palët e pakënaqura me vendime lidhur me vendet e tyre të punës kanë kërkuar nga Gjykata realizimin e të drejtave të tyre.

Padi të shumta janë bërë edhe ndaj Doganës së Kosovës dhe ATK-së, raste me të cilat merret divizioni fiskal në kuadër të DÇA-së.

Krahas seancave të monitoruara, IKD gjatë vitit 2019 ka mbledhur dhe analizuar afërsisht 100 aktgjykime nga rastet administrative të trajtuara nga DÇA i GjTh në Prishtinë.

Nga analiza e aktgjykimeve, IKD ka gjetur se të njëjtat nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm, në atë mënyrë që palët dhe publiku realisht të kuptojnë dhe të binden për arsyet e vendosjes si në dispozitivin e një aktgjykimi.

Në këtë drejtim, siç tanimë është trajtuar në këtë raport, e drejta për një gjykim të drejtë përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar:

“Dhënia e arsytimit adekuat për dënimin përfundimtar është e rëndësishë parësore. Arsyetimi dhe analizimi i qartë janë kërkesa thelbësore të vendimeve gjyqësore dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës në gjykim të drejtë të paraparë në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Cilësia e vendimeve gjyqësore varet kryesisht nga cilësia e arsytimit të tyre. Arsyetimi adekuat është domosdoshmëri e cila nuk duhet neglizhuar në interes të shpejtësisë”²⁰.

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, përmes opinionit nr.11 të vitit 2008, ka kërkuar që vendimet gjyqësore të jenë të arsyetuara, pasi që cilësia e vendimit varet nga kualiteti i arsytimit. Arsyetimet e vendimeve gjyqësore duhet të jenë konsistente, të qarta, jo dykuptimshme dhe jo kontradiktore²¹.

Disa prej aktgjykimeve të analizuara tregojnë në mënyrë të shkurtër kthimin e çështjes në rivendosje në rastet kur aprovohet padia, duke mos u lëshuar në një arsyetim konkret dhe në rekomandime konkrete për organin administrativ që do të shqyrtojë rekomandimin e gjykatës kur rasti kthehet në rivendosje tek të njëjtit.

Në këtë drejtim, logjikisht, kjo mungesë e arsytimit të këtyre aktgjykimeve krijon edhe situatën që organi administrativ nuk e nxjerrë vendimin e ri në përputhje me vendimin gjyqësor, për arsye se i njëjti është i paqartë dhe nuk i mundëson organit administrativ që të parashikojë saktë veprimet, çfarë paraqet cenim të theksuar të elementeve kryesore të sigurisë juridike. Kjo situatë rëndohet edhe më shumë kur kihet parasysh se sigurinë juridike në këtë rast e cenon pikërisht institucioni më i obliguar për të mbrojtur pikërisht sigurinë juridike.

Në këto aktgjykime zakonisht në paragrafët e parë të tyre, përshkruhet kronologjia e procedurës, padia, përgjigja në padi, deklaratimet gjatë seancave, përshkruhen provat e administruara, ku në disa raste për shkak të shablloneve të krijuara ka edhe lëshime teknike.

Sipas vlerësimit të IKD-së përmbledhja e atyre çka janë thënë në seancë nuk përbën arsyetim të një vendimi kur mungon arsyetimi i bazës mbi të cilën është vendosur si në dispozitivin e një aktgjykimi.

Tutje, sikurse në raportin paraprak, IKD ka gjetur se vazhdon të aplikohet mundësia e lejuar me ligj që gjykatësit e këtij departamenti rastet t'i kthejnë në rivendosje, dhe kjo sipas IKD-së po iu mundëson atyre që të vendosin në mënyrë formale, pa dhënë një arsyetim meritore për refuzimin apo aprovimin e padive.

Gjykatësit e këtij departamenti në shumë pak raste vendosin në mënyrë meritore për një çështje pa e dërguar fillimisht rastin në rivendosje.

²⁰ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore. Gjykata Supreme. 15 shkurt 2018. f.198 (http://www.oakks.org/repository/docs/Udhezues_per_Politiken_Ndeshkimore_Shkurt_2018_346913.pdf). (Qasur për herë të fundit më 12 prill 2020).

²¹ Paragrafi 36: Opinion i nr.11. (2008) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian i Këshillit të Evropës lidhur me kualitetin e vendimeve gjyqësore.

Sipas të dhënave që IKD ka nxjerrë pas analizimit të aktgjykimeve aprovuese, është gjetur se mbi 90% e këtyre aktgjykimeve janë aktgjykime sipas të cilave rasti kthehet në rivendosje në organin administrativ.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se kjo mënyrë e të vepruarit nga gjyqtarët, është burimi kryesor i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, pasi në këtë proces, zvarritja më e madhe e procedurës bëhet gjatë konfliktit administrativ nga DÇA i GjTh në Prishtinë, me praktikën për kthimin e rasteve në rivendosje.

Për këtë pjesë, ankesat dhe kritikët e vazhdueshme janë mos respektimi i vendimeve gjyqësore nga organet administrative, duke vendosur përsëri në mënyrë identike për të njëjti rast.

Duke marr parasysh se njëri ndër organet, vendimet e të cilit atakohen më së shpeshti nga palët është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), IKD ka analizuar aktgjykimet në këto raste.

Nga analiza e këtyre aktgjykimeve, IKD ka gjetur se të njëjtat arsyetohen vetëm formalisht, duke u bërë një përshkrim i rrjedhës së procedurës, dhe në fund duke u dhënë një konstatim i shkurtër se *“pala nuk ka ofruar dokumentacionin e mjaftueshëm”*.

Në këto situata të cilat janë shumë të shpeshta, palët obligohen që për realizimin e kërkesave të tyre t'i drejtohen gjykatës, dhe mënyra e veprimit të gjykatës në këto raste më pas shndërrohet në burim të vazhdueshëm të zvarritjeve procedurale.

Kjo pasi gjykata në rast të aprovimit të padisë, këto çështje i kthen përsëri në rivendosje tek organi administrativ, e që parimisht për realizimin e kërkesës së saj, palës i duhen edhe minimumi 2 vite të tjera.

Nga të dhënat e IKD-së të nxjerra nga monitorimi ditor i rasteve gjyqësore administrative, MPMS-ja përkundër vendimit gjyqësor merr vendim të njëjtë, e si rezultat i kësaj gjykata vetëm se e prolongon realizimin e të drejtës së palës përmes kthimit në rivendosje.

Për më tepër, duke vepruar në këtë mënyrë, DÇA-të përpos se prolongojnë vazhdimisht rastet administrative, të njëjtat nuk ndërtojnë standarde juridike, të cilat do të vlenin edhe në raste të tjera të natyrës së njëjtë, duke nxitur ligjshmërinë në gjitha organet administrative.

Në anën tjetër, nga monitorimi i DÇA të GjTh në Prishtinë, IKD ka gjetur një mbajtje *“shabllon”* të seancave gjyqësore, duke mos bërë që të njëjtat seanca të arrijnë qëllimin për një drejtësi më të mirë.

Në këtë drejtim, gjyqtarët e këtij departamenti caktojnë seancat gjyqësore njëhënë pas tjetrës, me një diferencë prej 15 apo 30 minutave, duke mos u dhënë palëve kohë të mjaftueshme për të paraqitur pretendimet e tyre.

Monitorimi i IKD-së gjenë se ka raste kur gjykatësi vetëm hyn në seancë pa hapur shqyrtimin gjyqësor fare, pa konstatuar palët dhe pa konstatuar objektin e shqyrtimit, derisa evidentohen

edhe raste kur provat shkruhen në procesverbal jashtë seancës nga sekretarja juridike, dhe të njëjtat nuk administrohen fare gjatë mbajtjes së seancës.

Lidhur me këtë mënyrë të veprimit ka pasur reagime nga ana e avokatëve të cilët janë shprehur të pakënaqur me mos administrimin e provave gjatë seancës, por jo edhe palët të cilat nuk kanë pasur përfaqësues.

Në këto raste rreziku që të mos administrohen prova vendimtare është i madh, e çka determinon edhe mënyrën e vendosjes.

Për këto arsye, IKD i rikujton gjykatësve në DÇA të GjTh në Prishtinë, se seancat gjyqësore nuk janë një procedurë formale pa ndikim në meritat e rastit, apo veprime procedurale “sa për tu bërë”, por se përmes të njëjtave duhet të sigurohet parimi i barabarësisë së palëve dhe mbrojtjes efektive të interesit publik e privat, në mënyrë që drejtësia në fund të jetë më e mirë.

Andaj, mbi këtë, IKD i rekomandon këtyre gjykatësve që seancat gjyqësore të mbahen me një kujdes dhe vëmendje të shtuar.

Lidhur me këtë çështje, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë se zgjatja e seancës nuk është çështje që varet nga Gjyqtarët, por nga vetë palët:

“Sa i përket diferencës-zgjatjes së seancave gjyqësore në DÇA, kjo nuk është çështje që varet nga gjyqtarët, por kohëzgjatja e mbajtjes së një seance varet nga veprimet dhe deklaratimet e palëve si dhe administrimit të provave në seancë. Gjyqtari në rastin e caktimit të seancës lidhur me kohëzgjatjen, e përcakton zgjatjen e seancës sipas kompleksitetit të lëndës-në DÇA. Vlenë të theksohet se ka lëndë të cilat mund të kryhen për një kohë më të shkurt, e po ashtu, ka lëndë që janë më shumë komplekse dhe për shqyrtimin e tyre nevojitet kohë me gjatë, mirëpo pa marr parasysh edhe pse gjyqtari e ka caktuar kufirin në mes seancave, kjo nuk ndikon që palët të mos kenë të drejt të mos deklarohen për të drejtat e tyre”²².

Në anën tjetër, LKA përcakton se “nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve”²³

Kjo dispozitë i përshtatet edhe vetë natyrës së procedurës administrative, në mënyrë që të mos pengohet administrimi i mirë i drejtësisë, derisa një normë e tillë ligjore rëndon pozitën e palës e cila mungon.

Dukuria e mos paraqitjes në seancë është dukuri jashtëzakonisht e shprehur në rastet kur të paditura janë organet shtetërore, e që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore. Ndër të tjera, kjo dukuri ishte konstatuar edhe në raportin paraprak të IKD-së mbi drejtësinë administrative.

²² Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Përgjigje elektronike për IKD. 07.05.2020.

²³ Ligji për Konfliktet Administrative. Neni 41.2.

9.1. Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve në Departamentin për Çështje Administrative

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës për zgjidhjen e lëndëve në DÇA, IKD ka përdorur formulën e cila aplikohet nga KGJK, ndonëse një formulë e tillë nuk është shumë e saktë dhe nga monitorimi që IKD i bënë DÇA-ve bëhet e ditur se një formulë e tillë nuk pasqyron kohëzgjatjen reale të proceseve gjyqësore në këtë Departament²⁴.

Në DÇA të GjTh në Prishtinë sipas të dhënave statistikore të kësaj gjykate, kohëzgjatja e trajtimit të një rasti prej momentit kur padia paraqitet në gjykatë e deri në ditë kur merret vendimi nga e njëjta është 786.95 ditë, pra që sipas formulës së KGJK-së i bie që ky Departament ka zgjidhur lëndët me efikasitet prej 92.95%.

Nga kjo mund të kuptojmë që një qytetarë për realizimin e të drejtës së tij përmes gjykatës, duhet të pres minimumi dy vite e gjysmë, gjithnjë sipas formulës matematikore së KGJK-së.

Ndonëse LKA-ja nuk ka të caktuar afatin kohor brenda të cilit një rast duhet të përfundojë në gjykatë, gjithmonë bazohet dhe vepron sipas parimin të efikasitetit që një lëndë të zgjidhet në kohë të arsyeshme duke mos përcaktuar afate specifike.

Lidhur me kohëzgjatjen e trajtimit të lëndëve administrative, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë se për shkak të numrit të madh të lëndëve të trashëguara nga Gjykata Supreme dhe numrit të madh të lëndëve të pranuara, është e pamundur që të gjitha lëndët të procedohen në të njëjtën kohë:

“Sa i përket pyetjes së prolongimit të rasteve gjyqësore administrative DÇA për shkak të numrit të lëndëve të trashëguara nga Gjykata Supreme dhe për shkak të numrit të madh të lëndëve të pranuara nga ana këtij departamenti është e pamundur që të gjitha lëndët të procedohen në të njëjtën kohë, mirëpo, gjykata procedon lëndët, ndërmerr veprimet për lëndët sipas arritjes se tyre në gjykatë, duke i ftuar palët në seancë dhe duke shqyrtuar lëndën sipas dispozitave ligjore në fuqi. Po ashtu, gjykata i procedon lëndët sidomos ato te cilat janë me prioritet (psh. lëndët që kanë të bëjnë me çështjet sociale – personat me aftësi të kufizuar, personat paraplegjik dhe tetraplegjik, ndihmat sociale etj, kontestet e punës dhe ato statusore - regjistrimi civil dhe gjendja civile) të përcaktuar me ligj”²⁵.

9.2. “Ping Pongu” me rastet në Drejtësinë Administrative

IKD vazhdimisht ka adresuar problematikën e kthimit të çështjeve në rivendosje nga Gjykata tek organi administrativ, kjo për faktin se nga praktika ka rezultuar që kjo e fundit të merr vendim të njëjtë, për çka pala është detyruar që për herë të dytë, për çështjen e njëjtë ti drejtohet gjykatës.

²⁴ Shënim: në Annexin 1 të këtij raporti do të paraqiten disa prej rasteve karakteristike ku do të trajtohet edhe kohëzgjatja e procedurës në këto raste.

²⁵ Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Përgjigje elektronike për IKD. 07.05.2020.

Mundësia ligjore që gjykata të kthej rastin në rivendosje tek organi administrativ dhe të mos vendos në mënyrë meritore ka bërë që të ketë zvarritje të procedurës dhe pamundësi që palët të realizojnë të drejtat e tyre në kohë të arsyeshme.

LKA përcakton se *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”*²⁶.

Por, përkundër kësaj, ky ligj ka përcaktuar edhe se *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*²⁷.

Në këto dy situata, ideja e të cilave është që në favor të administrimit të mirë të drejtësisë gjykatësit ti kenë duart e lira, të njëjtit kanë zgjedhur një situatë sipas të cilës lëndët kryhen më shpejtë, por nuk bëhet fjalë për administrim të mirë të drejtësisë.

Kjo për arsye se nga monitorimi sistematik, IKD ka gjetur se gjyqtarët në mbi 90% të rasteve veprojnë sipas situatës së parë, përkatësisht kthejnë rastin në organin administrativ, dhe nuk nxjerrin aktgjykim sipas të cilit do të vendosnin mbi çështjen administrative në mënyrë meritore. Në këtë situatë, palës i duhet të kthehet përsëri në organin administrativ të shkallës së dytë, dhe potencialisht, përsëri të filloj nga zero konfliktin administrativ në DÇA të GjTh në Prishtinë, dhe potencialisht ky proces të zhvillohet edhe në DÇA të Gjykatës së Apelit.

Përpos kësaj, sipas vetë gjykatësve të këtij departamenti, vendimet e organeve shtetërore janë pothuajse identike edhe pas udhëzimeve të gjykatës se çfarë duhet të veprojnë.

Në anën tjetër, me këtë mënyrë të veprimit, Gjyqtarët vetëm sa i ikin përgjegjësisë së tyre si akterët kryesorë për vënien e drejtësisë administrative, duke i'a lënë këtë në kompetencë organit administrativ.

IKD vlerëson se Gjyqtarët e DÇA duhet të kujdesen në secilin rast që të ketë administrim të mirë të drejtësisë, mënyra e kryerjes së të cilave raste, si tërësi, paraqet vetë pasqyrën e mirë/keq administrimit të drejtësisë.

²⁶ Ligji për Konfliktet Administrative, neni 43.2

²⁷ Po aty, neni 46.4.

Sipas IKD-së, për këtë situatë tanimë të krijuar, sipas të cilës sistemi gjyqësor nuk garanton një mjet efikas juridik në fushën e drejtësisë administrative, përgjegjësia primare bie tek vetë Gjyqtarët.

Në anën tjetër, mbi këto defekte të funksionimit të drejtësisë administrative, duhet të veprojë KGJK, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.

Vetë ideja e konceptit të vlerësimit të performancës është përmirësimi i sistemit gjyqësor, duke larguar veprimet dhe praktikat të cilat ndikojnë negativisht në administrimin e mirë të drejtësisë. Andaj, ky komision duhet të veprojë në mënyrë meritore, efikase dhe efektive, në mënyrë që të parandalojë praktika të tilla të cilat në instancë të fundit, dëmtojnë interesin juridik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.

Lidhur me këtë, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë se: “në bazë të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative, respektivisht neni 37 paragrafi 3, në mungesë të provave të dërguara nga e paditura (e cila edhe pse është e obliguar ligjërisht t’ia dërgoj gjykatës provat e lëndës) DÇA në mungesë të këtyre provave, është e obliguar të kthej në rivendosje rastin, për shkak se nuk mund të bazoj vendimin e saj pa iu dhënë mundësia palëve të deklarohe lidhur me provat e lëndës. Ndërsa neni 43 i LKA-së parasheh që kur gjykata nuk mund ta vërtetoj gjendjen faktike, ndërsa pala konteston këtë gjendje, atëherë edhe Ligji në shumicën e rasteve parasheh që gjykata ta obligoj organin administrativ ta vërtetoj një gjendje të drejt faktike dhe të merr vendim konform ligjit”²⁸.

9.3. Publikimi i aktgjykimeve të rasteve administrative

Neni 6.3. i Ligjit nr.06/L-054 për Gjykatat përcakton shprehimisht se “Gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi. Këshilli nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij neni”.

Lidhur me këtë obligim ligjor të gjykatave, IKD ka hulumtuar publikimin e aktgjykimeve administrative nga GjTh në Prishtinë dhe GjA, ku analiza është bërë pas muajit mars 2020, përkatësisht në kohën kur përfundon edhe afati i fundit për publikimin e aktgjykimeve të vitit 2019.

Sipas statistikave zyrtare të publikuara nga KGJK-ja lidhur me punën e gjykatës, del se ky departamenti gjatë vitit 2019, ka zgjidhur 2,929 raste, nga një total prej 9,244 rastesh sa në tërësi ka qenë i ngarkuar ky departament.

Nga 2,929 raste të cilat janë zgjidhur nga DÇA, 257 aktgjykime janë publikuar në ueb faqen e Gjykatës Themelore në Prishtinë²⁹.

²⁸ Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Përgjigje elektronike për IKD. 07.05.2020.

²⁹ Ueb faqja zyrtare e Gjykatës Themelore në Prishtinë. (Shih linkun <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/?r=M>). (Qasur së fundi më 12 prill 2020)

Lidhur me publikimin e aktgjykimeve, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë cikli i publikimit të aktgjykimeve në këtë gjykatë është duke vazhduar:

“Përkitazi me pretendimin tuaj se pse nuk janë publikuar të gjitha aktgjykimet nga Departamenti Administrativ edhe pse është kërkesë ligjore, ju informojmë se cikli i publikimeve është duke vazhduar, dhe si i tillë nuk është një proces i cili kërkon prerje të aktiviteteve në baza të kalendarit vjetor, që i bie se në vazhdimësi do të publikohen të gjitha aktgjykimet e gjykatës përfshirë edhe të DÇA-së. Për informimin tuaj Gjykata Themelore në Prishtinë mban numrin më të madh të aktgjykimeve të publikuara në përgjithësi në raport me të gjitha gjykatat tjera në Republikën e Kosovës”³⁰.

Ndërsa, Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019 ka zgjidhur gjithsej 825 lëndë, nga 1,369 sa kishte pasur në punë në total gjatë vitit 2019.

Nga 825 lëndë të përfunduara, në ueb faqen e kësaj gjykate janë publikuar vetëm 129 aktgjykime.³¹

Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, ka thënë se arsyeja e mos publikimit të gjitha aktgjykimeve në faqen zyrtare të Gjykatës është mungesa e stafit, pasi KGJK ende nuk e ka hapur një vend pune për një person i cili do ta kryente këtë detyrë:

“Krejt problem është që Këshilli Gjyqësor ende nuk e ka hap një vend pune për një person i cili kishte me kry këtë punë, ne këtë punë e kryejmë me praktikantë, me bashkëpunëtorë profesional, me zyrtarë ligjorë, për shkak se s’kemi një person të caktuar i cili do të merrej me publikimin e aktgjykimeve. Kjo është e vetmja arsye pse kemi një numër kaq të vogël të aktgjykimeve të publikuara, për shkak se ato duhet me u përpunu, me u anonimizu”³².

Po ashtu, ka raste kur aktgjykimet e njëjta janë publikuar më shumë se një herë në këtë ueb faqe, duke bërë që numri real i aktgjykimeve të publikuara të jetë edhe më i vogël.

Gjatë analizës së rasteve IKD, ka gjetur se publikimi i aktgjykimeve është selektiv, duke u publikuar më shumë raste të cilat kanë të bëjnë me anulimin e vendimeve lidhur me pensione, ndërsa rastet më të vjetra dhe më të komplikuar publikohen më pak.

9.4. Cilësia e aktgjykimeve të GjTh dhe GjA në rastet administrative

IKD, me qëllim të ofrimit të rekomandimeve konkrete ka analizuar rreth 100 aktgjykime administrative të GjTh dhe të GjA.

Pa komentuar mënyrën e vendosjes, IKD ka gjetur se në disa prej aktgjykimeve të publikuara mungon arsyetimi i detajuar lidhur me arsyet pse gjykata ka refuzuar apo ka aprovuar padinë.

³⁰ Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Përgjigje elektronike për IKD. 07.05.2020.

³¹ Ueb faqja zyrtare e Gjykatës së Apelit. (Shih linkun <https://apeli.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/?r=M>). (Qasur së fundi më 12 prill 2020)

³² Përgjigje telefonike për IKD nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala. 07.05.2020.

Disa prej aktgjykimeve, për shkak të shablloneve “copy – paste” përmbajnë edhe gabime teknike, të tilla si gabime në emrin e vet gjykatësit të palëve në procedurë apo gabime të tjera.

Në raste të tjera gjykata konstaton se vendimi është i ligjshëm apo të kundërtën duke mos dhënë arsye të mjaftueshme të cilat e bëjnë vendimin të paligjshëm, apo një gjë e tillë bëhet me një paragraf të vetëm.

Në raste kur e paditësi ushtron padi pas heshtjes administrative, gjykata merr vendim me të cilin e obligon organin administrativ të vendos, në vend që të vendos në mënyrë meritore, ndonëse kjo është një mundësi konform LKA, praktika dëshmon se një vendim i tillë vetëm se e zvarrit procedurën dhe ti pamundëson paditësit që ta realizoj të drejtën e tij në kohë të arsyeshme.

Ndërsa në aktgjykimet e GjA, vërehet një arsyetim më i detajuar lidhur me aprovimin apo refuzimin e pretendimeve ankimore të palëve.

Arsyetimi i aktgjykimit, është esencial për sigurimin e një gjykimi të drejtë, ai duhet të jetë i qartë, i saktë, konciz dhe analitik, i cili kërkon ndjekjen e një forme të strukturuar dhe kronologjike por jo përshkrim.

“Vendimi gjyqësor nuk mund të dominohet nga përshkrimet e deklaratave të palëve, dëshmitarëve, ekspertizave dhe provave. Është e rëndësishme që gjyqtari të shpjegoj pse dhe si ka arritur në përfundim për të cilën ka vendosur, pse iu ka besuar dëshmitarëve apo jo, pse i konsideron provat e caktuara të sakta, të vërteta dhe të besueshme apo nuk janë të tilla”³³

GjEDNj përmes vendimeve në disa prej rasteve të cilat do t’i theksojmë më poshtë, konsideron se gjykatat për vendimet e tyre duhet të japin arsye të mjaftueshme, se në çka i kanë bazuar ato.

GjEDNj në rastin Hadjianastassiou kundër Greqisë, konstaton se shtetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjetet e përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore përputhen me kërkesat e nenit 6 të konventës. Megjithatë, gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat ata bazojnë vendimet e tyre.

Një shembull të tillë GjEDNj e jep edhe në aktgjykimin Tatishvili kundër Rusisë, e cila thotë se gjykimet e gjykatave duhet të deklarojnë në mënyrë të duhur arsyet në të cilat ato kanë bazuar vendimet e tyre, konform nenit 6 të konventës³⁴.

Veç kësaj, e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në harmoni me ligjin, përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për aktvendimet e tyre me baza të arsyeshme në nivel procedural dhe material. Sigurimi i arsyeve kërkon shpjegime bindëse dhe të ndërtuara mirë për vendimin

³³ B.Hyseni. A.Zogaj. F.Hasani. “Doracak i gjyqtarëve për shkrimin dhe arsyetimin ligjorë”. Korrik 2017. Prishtinë. USAID - JSSP, f.81.

³⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Vendimi Tatishvili kundër Rusisë. (Shih linkun <https://www.legal-tools.org/doc/95cc48/pdf>). (Qasur për herë të fundit më 5 maj 2020).

e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë që të dyja: kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit ³⁵.

Duke u referuar në faktin se numri i rasteve të DÇA-së të kthyer në rigjykim nga instancat më të larta gjyqësore nuk është i lartë, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi, ka thënë se aktgjykimet kanë përmbajtje dhe arsyetim të mjaftueshëm:

“Sa i përket aktgjykimeve në çështjet e konfliktit administrativ, DÇA konsideron se, vlerësimi i përmbajtjes së arsytimit të aktgjykimeve, janë kompetencë e instancave më të larta gjyqësore, si Gjykata e Apelit dhe Supreme e Kosovës, për ti vlerësuar vendimet e DÇA. Sipas, një raporti vlerësues, vendimet të cilat atakohen në Gjykatën e Apelit dhe Supreme, nga palët ankimore, nuk është një përqindje e madhe e aktgjykimeve të DÇA, që anulohen- prishen nga instancat e larta gjyqësore, që do të thotë se aktgjykimet e DÇA kanë përmbajtje dhe arsyetim të mjaftueshëm ashtu siç është përcaktuar me ligjet në fuqi”³⁶.

9.5. Zvarritja e procedurës dhe ngarkesa e gjykatës me rastet e pensioneve

Karakteristikë e Divizionit Administrativ të DÇA-së në GjTh në Prishtinë është numri i madh i padive me të cilat atakohen vendimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht Departamentit të Administratës Pensionale.

Kjo për faktin se një numër i madh i lëndëve të kësaj natyre kanë të bëjnë me pensione të cilat kryesisht i takojnë kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe në disa raste pensioneve të dyfishta.

IKD gjatë këtij hulumtimi ka analizuar edhe vendimet e kësaj ministrie, ku gjatë analizës ka gjetur se këto vendime arsyetohen vetëm formalisht, duke u bërë një përshkrim i rrjedhës së procedurës, dhe në fund duke u dhënë një konstatim i shkurtër se “pala nuk ka ofruar dokumentacionin e mjaftueshëm”, çfarë paraqet shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtës qytetarëve në vendime të arsyetuara.

Mbi këtë bazë, mbi 90% e kërkesave të palëve refuzohen, madje refuzohen edhe ankesat e tyre duke lënë konfliktin administrativ rrugën e vetme për palët.

Palët obligohen që për realizimin e kërkesave të tyre t’i drejtohen gjykatës, dhe kjo konsiston në një procedurë e cila mund të shkojë nga 2 deri në 6 vite apo edhe më shumë.

Gjatë kësaj procedure palëve u shkarkohen shpenzime të shumta. Për më tepër, kjo krijon edhe ngarkesë të gjykatës me lëndë.

³⁵B.Hyseni. A.Zogaj. F.Hasani. “Doracak i gjyqtarëve për shkrimin dhe arsyetimin ligjorë”. Korrik 2017. Prishtinë. USAID - JSSP, f.81.

³⁶ Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi. Përgjigje elektronike për IKD. 07.05.2020.

Në këtë drejtim, IKD ka gjetur që përpos ngarkesës shumë të madhe që i shkaktohet gjykatës përmes këtyre lëndëve, pamundësohet edhe realizimi i kërkesave të palëve në kohë të arsyeshme, duke marr parasysh ndjeshmërinë e rasteve të kësaj kategorie.

Palët të cilat kërkojnë realizimin e këtyre te drejtave, dhe të cilët janë në gjendje jo të mirë shëndetësore obligohen që të udhëtojnë nga vende të ndryshme të Kosovës, me ç ‘rast u shkaktohen shpenzime të cilat nuk u kompensohen, pasi që sipas LKA-së shpenzimet procedurale bien në barrë të palëve³⁷.

Pra, organi administrativ në këto raste, ka mundësi të konstatoj përmes komisionit mjekësor gjendjen shëndetësore të palës, dhe jo të prolongoj realizimin e kërkesës së palës, pasi që edhe në rastet kur një e drejtë e tillë palës i njihet me vendim gjyqësor, ministria është e obliguar që pagesën e pensioneve ta kryej në mënyrë retroaktive.

Pra IKD, ka gjetur se përpos zvarritjes procedurale në konflikt administrativ, në këto raste nuk është e nevojshme fare që çështja të vijë në gjykatë, pasi që përmes një ekzaminimi të mirëfilltë mjekësor, pala mund ta realizoj të drejtën e tij në procedurë administrative.

Por, problematikë mbetet se DÇA nuk e adreson këtë problem, por siç u tha në rreshtat paraprak, në mënyrë “shablone” kthen në rivendosje këto lëndë pikërisht tek këto organe administrative, duke u dhënë të njëjtave ri-mundësinë që të shkelin të drejtat e qytetarëve.

Andaj, IKD vlerëson se kjo mënyrë e zhvillimit të procedurave administrative pranë organeve administrative është sinjal i fuqishëm se gjyqtarët e DÇA-ve duhet të marrin përgjegjësinë dhe të vendosin në secilin rast në mënyrë meritore, përjashtimisht situatave kur specifikat e rastit pamundësojnë këtë mënyrë të vendosjes.

³⁷ Ligji për Konfliktet Administrative. Hyrë në fuqi në shtator 2010. “*Neni 64 Në konfliktin administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta*”

10. ANNEX 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike të DÇA-ve

1. Rasti i Sefadin Blakaj kundër Odës së Noterëve të Kosovës

Gjykatës: Hajriz Hoti

Paditës: Sefadin Blakaj

E paditur: Oda e Noterëve të Kosovës (ONK)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të ONK

Data e parashtrimit të padisë: 28.07.2017

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 14.01.2020

Aktgjykimi: Refuzues

Faza e procedurës: Aktgjykim i shkallës së parë

Noteri Sefadin Blakaj, në korrik të vitit 2017 i ishte drejtuar DÇA të GjTh në Prishtinë, nga e cila kishte kërkuar që të anulohet vendimi i Këshillit për Arbitrazh dhe Disiplinë (KAD) të Odës së Noterëve, i cili kishte refuzuar ankesën të cilën Blakaj e kishte ushtruar ndaj vendimit të ONK-së.

Sipas vendimit të ONK-së, Blakaj për shkak të shkeljeve disiplinore ishte dënua me 4500 euro gjobë, si dhe përkohësisht i kishte pezulluar ushtrimi i funksionit të noterit, me arsyetimin se ai së bashku me bashkëshorten e tij, kishin themeluar kompaninë “Eurolex” L.L.C. si dhe “EuroLex&Estates” SH.P.K.

Sipas vendimit, ai po ashtu, në mënyrë të kundërligjshme kishte ngarkuar palët me pagesën shtesë për letrat e printuara.

Lidhur me pretendimin se një vendim i tillë ishte i kundërligjshëm, Blakaj kërkonte nga gjykata anulimin e këtij vendimi, po ashtu ai kishte kërkuar edhe kompensimin moral ndaj tij në shumë prej 200 mijë euro.

Kjo pasi që një procedurë të tillë disiplinore, gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 14 janar 2020, Blakaj e konsideronte të orkestruar nga KAD-i, duke kërkuar nga gjykata që vendimin e atakuar ta anulohet si të kundërligjshëm.

GjTh në Prishtinë, përmes aktgjykimit të datës 14 janar 2020, kishte refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit.

Gjykata kishte hedhur poshtë si të palejueshme kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ai kërkonte kompensimin e dëmit jo material të shkaktuar me vendimet e kontestuar në shumë prej 200.000 euro.

GjTh konstatoi se vendimi i të paditurës është i ligjshëm dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.



Ky gjykim për dallim nga shumica e seancave është karakterizuar me seanca të gjata, kjo duke marr parasysh faktin që seancat në DÇA, zakonisht caktohen në orar prej gjysmë orë, dhe rrallë herë nga një orë.

Gjykatës së shkallës së parë për trajtimin e këtij rasti i janë dashur 900 ditë, pasi që nga ushtrimi i padisë e deri në vendosjen e rastit në shkallë të parë kanë kaluar më shumë se dy vite.

Aktualisht ky rast gjendet në Gjykatën e Apelit, pasi që paditësi kishte qenë i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë.

2. Rasti i Sindikata e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës kundër Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Gjykatës: Arjeta Sadiku

Paditës: Sindikata e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)

E paditur: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të MASHT-it

Data e parashtrimit të padisë: 04.03.2019

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 14.05.2019

Aktgjykimi: Refuzues

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: 20.09.2019

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit: Kthim i rastin në rigjykim

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 30.12.2019

Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Themelore: Refuzues

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë

E pakënaqur me vendimin e MASHT-it të marr nga ministri i atëhershëm i arsimit, Shyqeri Bytyqi, për zëvendësimin e orëve të humbura për shkak të grevës, SBASHK-u kishte iniciuar konflikt administrativ ndaj MASHT-it.

Kërkesa e SBASHK-ut përmes kësaj padie ishte anulimi i vendimit për zëvendësimin e orëve të humbura me arsyetimin se një vendim i tillë është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me Ligjin për Grevat dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Lidhur me këtë padi, në GjTh në Prishtinë më 24 prill ishte mbajtur shqyrtimi gjyqësor, nga i cili kishte rezultuar se vendimi i MASHT-it është i ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Sipas vendimit të GjTh në Prishtinë të marr në maj të vitit 2019, padia e paditësit ishte e pabazuar dhe si e tillë ishte refuzuar.

Në këtë aktgjykim thuhej se vendimi i MASHT-it është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se kompensimi i orëve të humbura me rastin e grevës ka për qëllim zhvillimin arsimor të nxënësve dhe aftësimin e tyre social dhe profesional, kjo në përputhje me parimet e përgjithshme të arsimit para universitar të përcaktuara me Ligjin për Arsimin Para universitar.

Por, pala paditëse nuk kishte qenë e kënaqur me vendimin e shkallës së parë, për çka edhe kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit, në shtator të vitit 2019 kishte marr vendim me të cilin kishte anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim



301 ditë deri
në aktgjykim
të formës së
prerë

Pas kthimit në rigjykim, më 12 dhjetor të vitit 2019 ishte mbajtur seanca gjyqësore, gjatë të cilës SBASHK-u insistonte në kundërligjshmërinë e vendimit të ministrisë, duke kërkuar anulimin e tij.

Por, më 30 dhjetor 2019 GjTh në Prishtinë, sërish refuzoi si të pabazuar padinë e SBASHK-ut, duke e lënë në fuqi vendimin e MASHT-it për kompensimin e orëve të humbura për shkak të grevës.

Padia për këtë rast ishte ushtruar pasi që MASHT-i, më 27 shkurt 2019, kishte marr vendim për zëvendësimin e orëve të humbura për shkak të ndërprerjes së përkohshme të mësimin në institucionet e arsimit para universitar publik, si pasojë e grevës.

Në vendimin e MASHT-it thuhej se orët e humbura do të zëvendësohen pesë ditë gjatë pushimit pranveror, pesë ditë gjatë vitit shkollor dhe për pesë ditë do të zëvendësohen pas përfundimit të vitit shkollor.

Por, kundër këtij vendimi kishte qenë SBASHK-u, ku përmes padisë së ushtruar në gjykatë më 4 mars 2019, kishte kërkuar anulimin e këtij vendimi, me pretendimin se ai është i kundërligjshëm.

Ky gjykim ishte konsideruar me prioritet për shkak të afatit për zëvendësimin e orëve i cili ishte paraparë në qershor, nga ushtrimi i padisë e deri në vendosje kishin kaluar afro dy muaj.

Pas ankesës Gjykata e Apelit kishte vendosur për më pak se katër muaj.

Ndërsa Themeloria herën e dytë kishte vendosur për më pak se dy muaj.

Rrjedhimisht, orët e parapara që të zëvendësohen nuk janë zëvendësuar fare, dhe vendimi përfundimtar është marr në dhjetor të vitit 2019.

3. Selatin Retkoceri kundër Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina”

Gjykatës: Vjollca Limani

Paditës: Selatin Retkoceri

E paditur: Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” (KRU)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të Bordit të (KRU)

Data e parashtrimit të padisë: 14.12.2015

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 10.7.2019

Vendimi: Shpallet inkompetente

Faza e procedurës: Vendim i formës së prerë

Nga vitit 2015, paditësi Selatin Retkoceri kishte nisur betejën gjyqësore ndaj vendimit të Bordit të KUR, vendim me të cilin ishte shfuqizuar vendimi për caktimin e paditësit në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv.

Por, lidhur me këtë padi tek në korrik të vitit 2019, gjykatësja e rastit kishte caktuar një seancë në të cilën njoftoi paditësin se gjykimi i kësaj çështje nuk bie në kompetencë të këtij departamenti, me ç ‘rast kishte marr aktvendim për shpallje inkompetente.

Kjo për faktin se e paditura KUR Prishtina ka statusin e ndërmarrjes publike dhe te punësuarit e saj nuk janë kategori e shërbyesve civil, andaj kjo çështje u delegua në Departamentin e Përgjithshëm, Divizionin Civil të GjTh në Prishtinë.

Por përkundër faktit se DÇA i GjTh në Prishtinë nuk kishte qenë kompetent për gjykimin e kësaj çështje sipas përgjigjes në padi, rezulton se gjykatësja Luljeta Maxhuni, më 30 maj 2018 kishte nxjerr aktvendim për përgjigje në padi, të cilës më 18 korrik 2018, i ishte përgjigjur e paditura.

Në këtë rast gjykatësja Maxhuni kishte lëshuar aktvendim për përgjigje në padi, pa kontrolluar fillimisht nëse kjo çështje bie nën kompetencën e DÇA.

Dhe deri në vendosjen lidhur me kompetencën kanë kaluar 1,322 ditë, pra më shumë se katër vite.

Tashmë kanë kaluar katër vite dhe paditësi ende nuk ka arritur të realizoj kërkesën e tij lidhur me anulimin e vendimit me të cilin ishte larguar nga pozita e Kryeshefit.



4. Kompania “Sa- Sallahu” kundër Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Gjykatës: Arjeta Sadiku

Paditës: Kompania “Sa- Sallahu”

E paditur: Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit KPMM

Data e parashtrimit të padisë: 30.11.2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 18.11.2019

Aktgjykimi: Refuzues

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë

E pakënaqur me vendimin e KPMM-së të marr në tetor të vitit 2016, me të cilin kompanisë “Sa-Sallahu” i ishte refuzuar ankesa ushtruar ndaj vendimit për gjobën në shumë prej 22,247.03 euro, kompania kishte iniciuar konflikt administrativ.

Me pretendimin se e paditura është mbështetur në raportin e inspektimit, i cili nuk ka bërë vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, ashtu që duke bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ka bërë edhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kishte kërkuar nga gjykata të vlerësoj ligjshmërinë e aktit administrativ.

Por, për trajtimin e këtij rastit gjykatës i janë dashur më shumë se tre vite, ku më 18 nëntor të vitit 2019 kishte refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit, duke e lënë në fuqi vendimin mbi gjobën e shqiptuar ndaj kompanisë.

Përmes aktgjykimit gjykata kishte konstatuar se në këtë çështje administrative drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë janë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe ligji material, duke refuzuar kështu ankesën e paditësit.

Pa marrë parasysh vendosjes, paditësit i janë dashur të pres 1,058 ditë deri në marrjen e një vendimi nga gjykata e shkallës së parë.



5. “Aloka” kundër Organit Shqyrtues të Prokurimit

Gjykatës: Lirije Maksutaj

Paditës: Spitali Special për Kirurgji “Aloka”

E paditur: Organi Shqyrtuesi Prokurimit (OSHP)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të OSHP

Data e parashtimit të padisë: 23.01.2017

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 21.01.2020

Aktgjykimi: Refuzues

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë

Spitali Special për Kirurgji “Aloka” përmes padisë së ushtruar më 23 janar 2017, kishte kërkuar nga GjTh në Prishtinë, DÇA të anuloj vendimin e OSHP-së, me të cilin ajo pretendonte se i ishte pamundësuar fitimi i tenderit në projektin për Policinë e Kosovës, me titull “Shërbime Mjekësore Specialistike”.

Paditësja përmes padisë, kërkonte nga gjykata që ta obligoj të paditurën që t’i kompensoj edhe dëmin sipas ekspertizës financiare e cila do të përpilohet gjatë procedurës.

Kjo e pretendimin se e paditura me rastin e vendosjes kishte shkelur dispozitat procedurale, nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore si dhe nuk kishte arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike.

Por, një kërkesë e tillë është refuzuar nga gjykata me arsyetimin se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, dhe zbatuar dispozitat e ligjit material.

Vetëm deri në aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me këtë rast kanë kaluar 1,058 ditë.



6. Enis Haxhijaha kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

Gjykatës: Anita Nikci - Morina

Paditës: Enis Haxhijaha

E paditur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të MPMS

Data e parashtrimit të padisë: 10.07.2011

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 18.01.2017/13.05.2019

Aktgjykimi: Aprovues

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë

Paditësi Enis Haxhijaha, i pakënaqur me vendimin e MPMS-së kishte kërkuar na GjTh në Prishtinë DÇA, anulimin e këtij vendimi me të cilin atij i ishte refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës së pensionit invalidor.

Kjo kërkesë e tij ishte aprovuar në vitin 2017 nga GjTh në Prishtinë DÇA, dhe çështja ishte kthyer në rivendosje tek organi administrativ.

Por, përkundër rekomandimeve të gjykatës, e paditura sërish kishte refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës së pensionit, me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit të nevojshëm.

Në këtë rast gjykata meqenëse po vendoste në mënyrë meritore, gjatë këtij gjykimi angazhoi edhe ekspert të cilët konstatuan gjendjen shëndetësore të paditësit.


Eksperti pas ekzaminimeve kishte konstatuar se shkalla e invaliditetit të paditësit është mbi 50%, e që sipas tij, paditësi i përmbush kushtet për të qenë përfitues i këtij pensioni.

Pas përfundimit të gjykimit, gjykata lidhur me këtë rast mori aktgjykim me të cilin aprovoi padinë e paditësit, duke e obliguar ministrinë që t'ia njoh paditësit të drejtën në pension dhe në mënyrë retroaktive t'i paguaj paditësit pensionet e papaguara si pasojë e vendimit.

Ndryshe paditësi kishte filluar betejën e tij gjyqësore në vitin 2011, ku përmes padisë kishte kërkuar të anulohet vendimi i ministrisë dhe atij t'i njihet e drejta në pension.

Por, lidhur me kërkesën e tij ishte vendosur në vitin 2017, kur edhe gjykata kishte aprovuar padinë e tij dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje.

Përkundër rekomandimeve të gjykatës, MPMS-ja nuk kishte marr asnjë veprim procedural lidhur me këtë rast, dhe meqë kishin kaluar më shumë se tre muaj, paditësi kishte iniciuar sërish konflikt administrativ.



2864 ditë deri në
momentin që çështja
administrative ka
marrë formë të prerë

Sipas padisë së ushtruar më 4 prill 2017, paditësi Enis Haxhijaha kishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, anulimin e vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me të cilin i ishte refuzuar e drejta në pensionin për persona me aftësi të kufizuara.

Paditësi është përballur me një proces gjyqësor prej mbi 8 viteve dhe shpenzime procedurale për realizimin e të drejtës së tij për pensionin invalidor.

7. Kompania “Monimix” kundër Doganës së Kosovës

Gjykatës: Rexhep Gashi

Paditës: Kompania “Monimix”

E paditur: Dogana e Kosovës

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të Doganës

Data e parashtrimit të padisë: 07.03.2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 15.04.2019

Aktgjykimi: Aprovues (rivendosje)

Faza e procedurës: Aktgjykim i formës së prerë

Me pretendimin se malli i importuar gabimisht ishte vlerësuar nga Dogana e Kosovës sipas metodës 6 të Kodit Doganor të Akcizave, kompania “Monimix”, kishte kërkuar nga GjTh në Prishtinë DÇA, anulimin e vendimit të Doganës.

Sipas padisë, ky subjekt kishte importuar rrjeta qelqi për izolime, sipas faturës me vlerë deri në 10,378.00 euro, kurse për këtë vlerë në doganë kishte paguar 16,857.70 euro ngarkesë shtesë si obligim doganor.

“Monimix” sh.p.k kishte paraqitur padi më 7 mars 2016, ndaj vendimit të Doganës së Kosovës, me të cilin për mallin e importuar ishte ngarkuar me vlerë shtesë.


Sipas padisë, ky subjekt kishte importuar rrjeta qelqi për izolime, sipas faturës, me vlerë deri në 10,378.00 euro, kurse për këtë vlerë në doganë kishte paguar 16,857.70 euro ngarkesë shtesë si obligim doganor.

Mirëpo, paditësi konsideron që kjo shumë ishte shumë e lartë dhe metoda e vlerësimit gjashtë nuk kishte qenë metoda që duhej përdorur në vlerësim të këtij malli.

Andaj, me anë të padisë ka kërkuar anulimin e vendimit të doganës të datës 1 shkurt 2016, me të cilin atij i ishte refuzuar ankesa ndaj këtij vlerësimi të mallit.

Lidhur me kërkesëpadinë e paditësit GjTh në Prishtinë DÇA, mori aktgjykim me të cilin aprovoi si të bazuar padinë e paditësit, dhe çështjen e ktheu në rivendosje.

Lidhur me këtë rast paditësit i është aprovuar padia edhe çështja është kthyer në rivendosje, por për të marr një vendim të tillë kompania “Monimix” sh.p.k ka pritur afro 1,226 ditë, apo mbi tre vite.



8. Florent Muçaj kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës

Gjykatës: Vjollca Limani

Paditës: Florent Muçaj

E paditur: Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të KPK

Data e parashtimit të padisë: 23 nëntor 2015

Faza e procedurës: Në procedurë për herë të parë në Gjykatë Themelore

Edhe pak muaj bëhen 5 vite prej kur ish-anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile, Florent Muçaj, kishte ushtruar padi më të cilën kërkonte anulimin e vendimit të Këshillit me të cilin i ishte ndërprerë mandati i anëtarit,


Ai përmes padisë po kërkon të kompensohet mbi 11 mijë euro, për pagesat e parealizuar për 45 muaj, si rezultat i ndërprerjes së mandatit të tij.

Sipas padisë, thuhet se në vitin 2014, në mënyrë unanime me votat e anëtarëve të KPK-së ishte zgjedhur anëtar, ndërsa një vit më vonë, përkatësisht në vitin 2015, ky institucion atij ia kishte ndërprerë mandatin.

Por, një vendim të tillë paditësi po e konteston, për çka edhe po kërkon anulimin e tij, si dhe kompensimin e pagave për periudhën sa i është ndërprerë mandati.

Aktualisht lidhur me këtë rast është aprovuar nxjerrja e ekspertizës financiare në mënyrë që të përllogariten pagat e papaguara nga Muçajt, për shkak të ndërprerjes së mandatit.

Paditësi në këtë rast është dashur të pres mbi 4 vite, për fillimin e shqyrtimit e padisë dhe çështja është në procedurë të marrjes së provave.



Nga parashtimi i
padisë deri më 31
dhjetor 2019 kanë
kaluar 1,499 ditë

9. Lëvizja Vetëvendosje kundër Komunës së Kamenicës

Gjykatës: Lirije Maksutaj

Paditës: Lëvizja Vetëvendosje

E paditur: Komuna e Kamenicës

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të Komunës

Data e parashtimit të padisë: 21.06.2013

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 09.12.2019

Aktgjykimi: Hudhet poshtë

Faza e procedurës: Vendim i formës së prerë

Me konstatimin se Lëvizja “Vetëvendosje”, nuk i kishte shtjerr të gjitha mjetet juridike para se të ushtronte padi në DÇA të GjTh në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2019 kishte hedhur poshtë si të parakohshme, padinë e këtij subjekti politik, të ushtruar në vitin 2013.

Lëvizja Vetëvendosje, dega në Kamenicë, në qershor të vitit 2013, kishte iniciuar konflikt administrativ kundër Komunës së Kamenicës, me pretendimin se nuk i ishte lejuar qasje në dokumente publike, respektivisht nuk i ishin ofruar të dhëna për të drejtën pronësore lidhur me një ngastër në Komunën e Kamenicës.

Por sipas gjykatës, “Vetëvendosje” nuk kishte ushtruar ankesë ndaj vendimit për moslejim të qasjes në dokumente zyrtare, me ç ‘rast nuk kishte shtjerr mjetet juridike, siç është paraparë me Ligjin për Procedurën Administrative.

Lidhur me këtë rast paditësja kishte ushtruar padi në vitin 2013, derisa gjykata kishte hedhur poshtë një kërkesë të tillë si të palejueshme tek pas 2,195 ditëve.



10. Halil Kurmehaj kundër Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës

Gjykatës: Lirie Maksutaj

Paditës: Halil Kurmehaj

E paditur: KPMSHCK

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të KPMSHCK-së

Data e parashtrimit të padisë: 26.4.2017

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 29.11.2019

Aktgjykimi: Refuzim

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Paditësi ka ushtruar ankesë

Faza e procedurës: Në procedurë në Gjykatë të Apelit


Me pretendimin se ishte diskriminuar gjatë rekrutimit për pozitën e Zyrtarit Administrativ në Kuvendin e Kosovës, paditësi Halil Kurmehaj, kishte kërkuar nga GjTh në Prishtinë, DÇA anulimin e vendimit të KPMSHCK-së.

Sipas tij, Kuvendi i Kosovës gjatë procesit të rekrutimit nuk kishte zbatuar në mënyrë të drejtë dhe transparente rregulloren për rekrutimin e shërbyesve Civil të nxjerr nga Qeveria e Kosovës, me ç ‘rast kishte anashkaluar testimin me shkrim.

Por pretendimet e tij përmes padisë i kishte konsideruar të pabazuara GjTh në Prishtinë, e cila kishte marr aktgjykim me të cilin kishte refuzuar padinë e paditësit si të pabazuar.

Ndryshe, sipas padisë së ushtruar më 26 prill 2017, paditësi Halil Kurmehaj kishte kërkuar nga GjTh në Prishtinë, të anuloj vendimin e KPMSHCK-së, pasi që sipas tij procedura e rekrutimit për pozitën kontestuese nuk kishte qenë transparente dhe se kishte qenë diskriminuese.

Në këtë rast paditësit i janë dashur të pres 935 ditë apo më afro tre vite në kontestin e tij të punës.



Nga parashtrimi i
padisë e deri më
31 dhjetor 2019
kanë kaluar 947
ditë

11. “C&G D.O.O.& Komtel Project Engineering” kundër Organit Shqyrtues të Prokurimit

Gjykatës: Luljeta Maxhuni


Paditës: “C&G D.O.O.& Komtel Project Engineering”

E paditur: Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të OSHP-së

Data e parashtrimit të padisë: 02.08.2017

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: Në proces



Nga parashtrimi i
padisë e deri më 31
dhjetor 2019 kanë
kaluar 881 ditë

Është mbajtur vetëm seanca përgatitore në rastin ku kompania “C&G D.O.O.& Komtel Project Engineering” po kërkon nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, të anulojë vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), si të kundërligjshëm.

Në padinë e ushtruar më, më 6 korrik 2017, thuhet se tenderi në aktivitetin e prokurimit “Instalimi i grupeve matëse në mes KOSTT/KEK/OSSH”, kundërligjshëm i është dhënë kompanisë “Np Monten Dhe G3 Inxhinjering”.

Kjo pasi që sipas padisë, vendimi i të paditurës është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik.

Ndërkaq, OSHP-ja më 6 korrik 2017, kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e kësaj kompanie, në aktivitetin e prokurimit “Instalimi i grupeve matëse në kufirin në mes KOSTT/KEK/OSSH”.

Ajo kishte lënë në fuqi vendimin mbi dhënien e tenderit kompanisë fituese, “Np Monten Dhe G3 Inxhinjering”, por me një vendim të tillë nuk po pajtohet paditësja, e cila po kërkon anulimin e këtij vendimi si të kundërligjshëm.

Lidhur me këtë rast kanë kaluar 2 vite e gjysmë nga ushtrimi i padisë por që rasti i kompanisë në fjalë ende nuk ka marrë epilog.

11. Rekomandime

1. MD me rastin e draftimit të ligjit të ri për Konfliktet Administrative, të përcaktojë afate të qarta procedurale përmes të cilave zhvillohet procedura gjyqësore në konflikt administrativ.
2. MD të përcaktojë në mënyrë taksative rastet kur Gjykata ka të drejtë që lëndën ta kthejë në rivendosje, me qëllim të shmangies së praktikës së “ping-pongut” në mes Gjykatës dhe organit të administratës.
3. Sistemi gjyqësor të angazhohet maksimalisht që në drejtësinë administrative të sigurohet mjeti efektiv juridik, ashtu siç edhe përcaktohet me Kushtetutë, KEDNJ dhe jurisprudencën e GjEDNJ-së.
4. KGJK të bëjë një analizë të detajuar për ndaljen e regresit në kuptim të stabilitetit me lëndë të DÇA të GjTh në Prishtinë.
5. KGJK të bëjë një analizë të detajuar lidhur me gjendjen e DÇA-ve, që e njëjta të shërbejë për ndërmarrjen e masave adekuate për stabilizimin e DÇA-ve.
6. KGJK urgjentisht të fillojë draftimi e rregullores së re mbi përcaktimin e normave të punës së gjyqtarëve.
7. KGJK përmes mekanizmave të saj të mbajë përgjegjësi gjyqtarët që tregojnë performancë të pamjaftueshme.
8. Përjashtimisht rasteve kur prioriteti i shqyrtimit të lëndës përcaktohet me ligj apo me vendime të KGJK-së, lëndët në Departamentin për Çështje Administrative të trajtohen sipas radhës së arritjes në Gjykatë.
9. Gjyqtarët e DÇA-ve të arsyetojnë aktgjykimet, në mënyrë që të respektojnë të drejtën e qytetarëve në një vendim të arsyetuar.
10. Gjyqtarët në aktgjykimet e tyre të aplikojnë jurisprudencën e GjEDNJ-së.
11. Në rast se lënda kthehet në rivendosje, aktgjykimet të përmbajnë rekomandime konkrete dhe të qarta se si duhet të veprojnë organi administrativ për menjanimin e shkeljeve.
12. DÇA i GjTh të shqyrtojë mundësinë që të vendosë në mënyrë meritore në secilin rast, përjashtimisht situatave kur kthimi i rastit në rivendosje imponohet nga specifikat e lëndës.
13. Gjykata e Apelit të shqyrtojë maksimalisht mundësinë që në rastet e saja të vendosë vetë, dhe jo që në të shumtën e rasteve, lëndët t’i kthejë në rigjykim.
14. Gjykatat në përputhje me Ligjin nr.06/L-054 për Gjykatat të publikojnë të gjitha aktgjykimet.
15. MPMS të trajtoj në mënyrë të mirëfilltë rastet ku palët kërkojnë t’u njihen të drejtat për pensionet nga skemat pensionale, siç është paraparë me ligj.
16. MPMS të arsyetojë vendimet në rastet kur refuzon kërkesat e palëve, të jap arsyeje të bazuara lidhur me refuzimin e kërkesave, si dhe Komisioni Mjekësor i cili funksionon në kuadër të kësaj ministrie të shqyrtoj me seriozitet dhe profesionalizëm kërkesat e palëve.
17. Organet administrative të nxjerrin vendimet konform rekomandimeve të dhëna nga gjykata.